



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

**NJOFTIM PËR MEDIA**

Ditën e premte, në datën 07 janar 2022, në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), u zhvillua mbledhja e radhës së AMA-s, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

<b>Armela</b>	<b>KRASNIQI</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Sami</b>	<b>NEZAJ</b>	<b>Zëvendëskryetar</b>
<b>Gledis</b>	<b>GJIPALI</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Suela</b>	<b>MUSTA</b>	<b>Anëtar</b>

AMA pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës vendosi:

1. Pranimin e kërkesës së subjektit, shoqërisë “ALBTELECOM” sh.a., mbi ndryshime në strukturën e pronësisë të këtij subjekti, për kalimin e aksioneve të “CETEL TELEKOM ILETISIM SANAYIVE TICARET ANONIM SIRKETI”, aksionar me 80,27% të aksioneve, tek aksionari “41G NYIL V ANOSAN MUKODO RESZVENYT ARSASAG”. **(Vendimi nr. 01, datë 07.01.2022)**
2. Konstatimin e pavlefshmërisë së licencës së shoqërisë “EMI Advertisement & Co” sh.p.k., për subjektin audio privat vendor “Radio Fantasy”. **(Vendimi nr. 02, datë 07.01.2022)**
3. Konstatimin e pavlefshmërisë së autorizimit të subjektit person fizik Albi Kreçi, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjetin kabllor “Tv Kabllor ALB-VITO Peqin”. **(Vendimi nr. 03, datë 07.01.2022)**
4. Ndryshimin e vendimit të dënimit me gjobë, nr. 14, datë 10.11.2021, të grupit të inspektorëve të AMA-s, duke ulur masën e sanksionit nga 2 000 000 lekë, në masën 1 000 000 lekë, vendosur ndaj shoqërisë “Tibo” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve, mbështetur në rrjet IP (OTT) dhe refuzimin e ankimit administrativ për pjesën tjetër. **(Vendimi nr. 04, datë 07.01.2022)**

**AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE**

**Tiranë, më 07.01.2022**